



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 3/17
Prishtinë, më 24.10.2017, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontiq, Dardan Molliqaj, Ali Lajçi, Mytaher Haskuka, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku dhe Envere Hoti.

Munguan: Blerim Kuqi, Myfera Serbica-Shinik.

Pjesëmarrës të ftuar: Bedri Hamza, ministër i Financave, Shkëlzen Morina, drejtor i DTP-së në Ministrinë e Financave, Ahmet Ismaili, drejtor i Thesarit në Ministrinë e Financave, Afërdita Maliqi, kryetare e Bordit të RTK-së, Ismet Bexheti, anëtar Bordit të RTK-së.

Stafi mbështetës i Komisionit: Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku, kryetar i Komisionit

Rendi i ditës

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt.10.10.2017;**
3. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme;**
4. **Shqyrtimi i Raportit financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën janar-shtator 2017 dhe Programit të Shpenzimeve të RTK-së, për periudhën tetor-dhjetor 2017;**
5. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës;**

Kryetari, konstatoi se rendi i ditës u miratua njëzëri pa ndryshime.

2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt.10.10.2017;**

Kryetari, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e Komisionit e datës 10.10.2017, u miratua pa vërejtje.

3. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme;**

Kryetari – Qeveria e ka proceduar Projektligjin për tatimin në pronën e paluajtshme dhe ne si Komision Funkcional jemi ngarkuar që ta shqyrtojmë atë dhe të raportojmë në Kuvend. Çështja kryesore e trajtuar me këtë projektligj është rregullimi i tatimit në pronën e paluajtshme, përcaktimi i rregullave dhe procedurave në komunat dhe Ministrinë e Financave. Kjo ka të bëjë me hartimin e ri të bazës ligjore për tatimin në pronë, me qëllim të përmirësimit dhe të përshtatjes së kuadrit ligjor për rregullimin dhe implementimin e tatimit në pronë dhe krijimin e një sistemi modern dhe efikas për mbledhjen e të hyrave nga tatimi në pronë. Përveç të tjerave, me këtë projektligj është paraparë fillimi i aplikimit të tatimit në toka, përmirësimi i procesit të vlerësimit të pronave të paluajtshme, përcaktimi i mekanizmave të ri shtrëngues për vlerën e detyrimeve tatimore të papaguara, mbrojtja e mëtejshme e interesave të tatimpaguesve dhe të shtresave në nevojë.

Bedri Hamza - Ministria e Financave ka ndërmarrë një reformë të rëndësishme, e cila ka për qëllim fillimin e implementimit të tatimit në tokë dhe krijimin e një sistemi efikas për tatimin në pronën e paluajtshme, i cili paraqet burim të rëndësishëm të financave lokale. Me këtë projektligj bëhet përshtatja e infrastrukturës ligjore me qëllim të implementimit të tatimit në tokë dhe krijimin e stimuljeve dhe shfrytëzimit produktiv të tokës, zbritjen e shkallëzuar nga baza e tatimit gjatë vitit të parë të implementimit të tatimit në toka dhe me kalimin e viteve do të njeh zbritje graduale.

Kjo e bënë më të lehtë fillimin e aplikimit të tatimi për tokën dhe pronën, duke përcaktuar se cili subjekt bartë përgjegjësinë e obligimit të tatimit në kohë në raste të ndryshme, përmirësimin cilësorë të procesit të vlerësimit të pronave të paluajtshme dhe rregulla të reja për regjistrimin e pronave të paluajtshme, të cilat do t'na mundësojnë krijimin dhe përmirësimin e regjistrave në pronë në bazën e të dhënave me prona të reja të regjistruara për regjistrime më të plota, përcaktimin e rregullave mbi faturimin e mungesën e detyrimeve tatimore, shpërndarjen e pagesave e kthimin e pagesës të detyrimeve tatimore, mekanizmat e ri për blerjen e shoqërimeve tatimore të papaguara.

Parashihet një rritje e shumës së zbritjes për vendbanimet primare, rregulloret e reja për shtyrjen e pagesës në pronë dhe mënyrat e poseduara të njoftimit. Ministria e Financave për hir të transparencës do të jetë e obliguar në të ardhmen të publikojë një faqe elektronike në lidhje me tatimin në pronë. Projektligji është konsultuar gjerësisht me komuna si përfitueset kryesore, publikun edhe grupe tjera të interesit.

Kryetari - Konsideroj se projektligji është një bazë e shëndoshë në reformën tatimore e në veçanti me stimujt që jep për tokat bujqësore, diçka e domosdoshme për Kosovën.

Dardan Molliqaj –Po na mungon deklarata financiare e projektligjit dhe po ashtu, po na mungon memorandum i shpjegues, i cili e lidhë me rregullat e BE-së, për të parë nivelin e përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së. I kam disa vërejtje të cilat do t'i paraqes edhe me amendamente plotësuese. Pika kyçe që është me rëndësi është vlerësimi i pronës e mendoj se kjo paraqet një nga instrumentet me të rëndësishme që ka ligji për shkak se një gjë e tillë pastaj përcakton edhe tatimet dhe të gjitha obligimet e tjera.

Sa i përket vlerësimit të pronës, sugjerimi jonë është që për licencimin e pronës, duhet me qenë ose përfaqësuesi i komunave veç e veç ose përfaqësuesi i Asociacionit të Komunave dhe nuk duhet të mbetet siç është propozuar kështu në projektligj, përfaqësuesi i komune ose odave tjera.

Sa i përket tatimit në pronë për tokat bujqësore, unë besoj që duhet të kemi një ndryshim, që nëse tokat bujqësore nuk punohen, do të ketë tatim më të lartë. E di që kjo nuk tingëllon mirë për plotë njerëz, mirëpo, për çështjen e zhvillimit ekonomik duhet ta bëjmë këtë hap, për shkak se besojmë që duhet t'i shtyjme njerëzit ose të fillojnë t'i punojnë tokat ose ato ti dhënë në shfrytëzim.

Ajo që do të shtoja është se në neni 11 - zbritje për vendbanimin për paqësor, po ashtu, tatimin në pronë e banim paqësor, duhet me qenë më i lirë se tatimet për vendbanimet e tjera. Do të saktësojmë këtë gjë përmes amendamenteve.

Sa i përket kategorizimeve, ajo që besojmë që duhet me u ndërrua, është prona rezidenciale dhe më shumë me qenë pronë e banuar për banime sepse te prona kategorisë rezidenciale po futen edhe hotelet, vilat turistike e shtëpitë e pleqve dhe mendoj që duhet me i nda, e mos të jetë e njëjta njësi banimi.

Tek neni 8 - rregullat e klasifikimit duhet me i shtua disa nënkategori, të cilat janë për shumën e tatimit, ndërtesat e shfrytëzueshme nga pronari, ndërtesat e dhëna me qira dhe të pashfrytëzuara, dhe për këto duhet me pas dallime të ndryshme prej tatimit dhe kategorisë. Kjo do ndikojë shumë në ekonomi, pasi që janë bërë shume ndërtime të pashfrytëzueshme e të pabanueshme.

Tek neni 3, te përkufizimi 1.26 - zona publike që shfrytëzohet, mbase edhe këtu si tek rezidencialet me e ndërrua sepse shfrytëzim të përbashkët, po përfshihen si ato publike edhe ato rezidenciale dhe mendoj se duhet të dallohen.

Kryetari – Sa për informim, vlerësimi i ndikimit buxhetor dhe deklarata e përputhshmërisë së projektligjit me legjislacionin e BE-së, janë pjesë e projektligjit që është shpërndarë në kutitë e deputetëve .

Naser Osmani - Konsideroj që ky projektligj është i rëndësishë së veçantë për komuna. Por, në këtë rast më intereson mendimi i ministrit sa i përket zonave ekonomike, parqeve industriale ku zhvillohet biznesi aktiv, a ishte dashur të lirohen këto vende nga tatimi në pronë, kur dihet se këto biznese krijojnë të hyra për buxhetin e Kosovës?

Bedri Hamza – Sa i përket çështjeve të ngritura, besoj që pas leximit të parë në seancë plenare, gjatë punës në komision do të jemi prezent dhe mendoj se aty ku e vlerësojmë që duhet të bëjmë amendamente, ne jemi të gatshëm të kontribuojmë me sqarime dhe të bëhen ndryshimet e nevojshme.

Pas diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisionit me 6 (gjashtë) vota Për, 3 (tre) Abstenime dhe asnjë Kundër, Komisioni nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr.06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

4. Shqyrtimi i Raportit financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën janar-shtator 2017 dhe Programit të Shpenzimeve të RTK-së, për periudhën tetor-dhjetor 2017;

Kryetari – Me miratimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, RTK-ja është organizatë buxhetore dhe e ka të ndarë buxhetin 11 milionë euro në kategorinë subvencione e transfere. Në nenin 11, paragrafi 5 të Ligjit për buxhetin 2017 është përcaktuar që RTK-ja, para secilit tremujor të dorëzojë në Kuvendin e Kosovës programin e shpenzimeve të planifikuara si dhe raportin financiar tremujor për shpenzimet e bëra. Mbi këtë bazë ligjore, RTK-ja ka dorëzuar në Kuvend programin e shpenzimeve për tremujorin e fundit, ku kërkohet që ti lejohet transferi i mjeteve në llogarinë zyrtare të hapur nga thesari.

Afërdita Maliqi –Ashtu siç është paraparë me Ligjin e Buxhetit 2017, RTK-ja e ka përcjell në Kuvend raportin me planin e shpenzimeve për tremujorin e këtij viti. Por gjithashtu e kemi dorëzuar në Kuvend edhe raportin financiar janar-shtator 2017. Sa i përket tremujorit të tretë, nga korriku e deri në shtator, RTK-ja është ballafaquar me një situatë, kur Qeveria ka heq nga buxheti i saj 350,000 euro me arsyetimin se nuk është miratuare Ligji për huazim dhe Qeveria tash na ka njoftuar se këto para do ti rikthehen RTK-së.

Sa i përket raportit financiar, RTK-ja paraprakisht e ka shqyrtuar atë dhe duke i marr parasysh specifikat që i bartë çdo periudhë tremujore, ne nuk kemi hasur në mangësi, por kemi debatuar më shumë çështjet për të cilat është kërkuar sqarim shtesë nga menaxhmenti dhe Zyra e Financave.

Sa i përket periudhës raportuese janar-shtator, është ndarë shuma prej 9.460.965 euro dhe të shpenzuara janë 9.486.917 euro, prej të cilave në kategorinë paga janë 4.684.680 euro apo 99.76%, mëditje, kontribute e kontrata kolektive 825.823 euro apo 93.60%, në kategorinë investime kapitale 636.042 euro apo 54.36%, shërbime komunale 198.851 euro apo 81.58%, mallra e shërbime 3.101.585 euro apo 125.63%. Po ashtu, vlen të theksohet se periudha janar-shtator e realizimit të të hyrave ka qenë më e lartë në shumën prej 13.739 euro krahasuar me shpenzimet e realizuara në këtë periudhë.

Kryetari –Për nivelin e organizatës që e keni dhe për shumën e parasë që merrni, një raport i tillë i RTK-së nuk është i denjë. Në prezantim, strukturim dhe në detaje është raport i mangët dhe shpresoj që ne raportimet tjera në këtë komision do ta ndryshojmë këtë formë të raportimit, sepse nuk pranoj që anëtarët e këtij komisioni të mos mjaftohen me respekt të mjaftueshëm në informacione që duhet dhënë. Në fund do të propozoj që të bëjmë një grup punues për me i përcaktua disa standarde të veçanta të raportimit për RTK-në dhe me qëllim që në mbledhjen e ardhshmet, derisa të bëhet Ligji për RTK-në, të kemi një raport më të denjë sepse ky raport nuk është i mirë.

Sa i përket shumës prej 350.000 eurove të papaguara në kohën ku s’ka pasur komision parlamentar, ne nuk do ti kthejmë në formë retroaktive sepse nuk na takon neve. E dyta, çështjen e shumës së paraparë prej të hyrave të AKP-së prej 1.4 milion euro, na qartëso ministër i financave a kemi bazë ligjore mbi ato para, tash para rishikimit të buxhetit?

Bedri Hamza - Me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës 2017, RTK-së i janë ndarë 11 milionë euro. RTK-ja i ka marrë deri tash kur po raportojmë 7.900.000 euro. Pjesa e mbeture për me u plotësua shuma e plotë është 3.100.000 euro dhe nga kjo shumë 1.400.000 euro janë pjesë e rishikimit të buxhetit. Pjesa e mbetur prej 1.4 milion eurove, e cila ka qenë e paraparë prej të hyrave të AKP-së për shkaqe të njohura nuk ka kaluar në Kuvend. Shuma prej 1.4 milion euro është kalim i mjeteve prej financimit të paraparë nga të hyrat e AKP-së në pjesën prej financimit nga të hyrat e rregullta të buxhetit të Kosovës. Nëse komisioni rekomandon, ne si Ministri e Financave mund të bartim mjetet prej 1.7 milion eurove në llogarinë e RTK-së, për periudhën e mbetur të vitit, ndërsa shumën prej 1.4 milion euro, pasi që të kalojë rishikimi i buxhetit që besoj se do të miratohet në Kuvend.

Dardan Molliqaj – Ne po e diskutojmë aspektin financiar të RTK-së, dhe meqenëse ne po dërgojmë para diku, duhet me pa se çfarë po bëhet me ato para dhe si po shpenzohen. Unë mendoj se në këtë takim ishte dashur të jetë edhe drejtori menaxhues i RTK-së për të raportuar dhe mendoj që është e rëndësishme që kryetari i Komisionit të dërgojë një vërejtje për mospraninë drejtorit, i cili është përgjegjës për të mirat e për të këqijat që ndodhin në këtë medium publik.

Sa i përket raportit financiar, shihet se investimet kapitale janë realizuar vetëm 54.36%, pra në kategorinë e vetme që ishte dashur me u shpenzua mjetet e planifikuara. Ndërsa, aty ku është dashur më së paku me shpenzua paratë, siç është kategoria e mallrave dhe e shërbimeve, kemi tejkalim të shpenzimeve prej 125.63%. Në RTK edhe pse jeni të punësuar mbi 700 persona, krejt thujse produktet apo emisionet i bleni jashtë dhe nuk mundeni me prodhura shërbime brenda. Unë mendoj se kjo ka një shpjegim të qartë sepse kjo është mënyra e vetme me vjedh prej buxhetit dhe RTK-ja ka krijuar kompani të cilat prodhojnë emisione të familjarëve të miqve apo shokëve. Unë mendoj se ne duhet me rishikua këtë aspekt financiar sepse nuk ka logjikë ekonomike me pas kaq të punësuar dhe kaq miliona euro buxhet dhe në fund me i ble krejt shërbimet. Unë natyrisht që jam kundër me i nda mjete RTK-së, me këtë mënyrë të menaxhimit. Unë dhe Lëvizja Vetëvendosje jemi me e bë temë dhe kauzë këtë sepse realisht po vidhni para me letra dhe atë shuma të mëdha.

Ju bëj thirrje si bord për vitin e ardhshëm që mos të veproni në këtë formë me mënyrën e shpenzimeve dhe menaxhimit të buxhetit. Unë do të interesohem në detaje se kush janë këta pronarë që po bleni

mallra prej tyre, cilat janë lidhjet me drejtorët menaxhues e me të politikës, për këta miliona humbje të parasë publike.

Naser Osmani – Me qenë se relacioni jonë është me bordin, konsideroj që atë që e tha kryetari, ne duhet me ndryshua qasjen e raportimit duke krijuar një standard të mirë dhe në detale, pasi që kemi nevojë për detalizim të shpenzimeve dhe e them lirisht se ai që arrin ta futë në sistem RTK-në do të jetë hero i institucionalizimit në Kosovë.

RTK-ja është një institucion i Kuvendit, për të cilin ne gjithmonë kemi pasur interesim të jashtëzakonshëm, por nuk kemi qenë asnjëherë në atë rolin shumë të hetuesit apo kontrolluesit, dhe këta po ashtu nuk kanë bërë përpjekje të madhe për t'na bindur për shpenzimet dhe si rezultat i menaxhimit jo të mirë, kanë bërë tejkalime dhe kanë hyrë në borxhe mbi 2 milion euro. Është e vërtetë se këta kanë edhe të hyra vetjake dhe kjo iu mundëson me qenë super të privilegjuar prej mediave të tjera sepse në të njëjtën kohë financohen nga buxheti i shtetit. Por kanë edhe probleme sepse janë ligjërisht të obliguar të ofrojnë disa shërbime, si programet për minoritete, programet tjera RTK 1,2, 3 dhe 4. Sa i përket të punësuarve e vërteta është se këta nuk i kanë 760 punëtorë, por më shumë se 1000. Prej tyre 400 apo më shumë punëtor i kanë kontratat mbi vepër.

Pyetja jonë është pse jemi në këtë situatë dhe çfarë mund të bëjmë? Këta e dinë se janë të fuqishëm dhe ne si pjesë e politikës e kemi vështirë me i lënë pa buxhet sepse mbyllet mediumi publik dhe përsëri shkon në dëm të politikanëve dhe këtë situatë këta e shfrytëzojnë maksimalisht dhe është përgjegjësi jona pse i kemi lënë në këtë pozitë. Mosndryshimi i ligjit është neglizhencë e deputetëve të Kuvendit.

Sa i përket mjeteve prej 1.4 milion euro, ashtu siç e shpjegoi ministri financave me rastin e miratimit të buxhetit janë paraparë si të hyra prej AKP-së dhe tani me rishikim të buxheti propozohet që të ndërrohet burimi nga të hyrat e rregullta. Po ashtu, duhet shikuar edhe çështjen e konfliktit të interesit sepse ka raste që punëtorët e RTK-së marrin projekte nga ky televizion. Megjithatë, duke pasur parasysh pagat e të punësuarve dhe për shkakun e disa punëtorëve dhe gazetarëve të devotshëm që nuk kursejnë asgjë për ndonjë lajmë të saktë, unë jam për atë që ti ndahet shuma e mjeteve për muajt në vazhdim.

Mytaher Haskuka –Edhe po të kishte qenë një organizatë joqeveritare do të isha kundër raportit financiar të prezantuar dhe jo më RTK-ja si një organizatë buxhetore me prezantua një raport të tillë, as të formatizuar, as të renditur sipas numrit të faqeve, dhe nuk mund të kuptosh situatën reale në këtë medium publik. Në mungesë të formatizimit të faqeve është problem me i shikua tabelat dhe të bëhen krahasime në mes tyre dhe kategorive të shpenzimeve. Por edhe duke pasur parasysh nivelin e shpenzimeve, tejkalimin e mallrave dhe shërbimeve mbi 125% dhe nivelin e ultë të investimeve kapitale prej 56 %, pa marrë ndonjë shpjegim të arsyeshëm pse ka ndodhur kështu dhe pa shpjegime me shkrim në raport është problematike me marrë një vendim për ndarjen e mjeteve tjera.

Sa i përket shpenzimeve kapitale, kemi shpenzime të teknologjisë informatike, por edhe kompjuterë, a janë e njëjta gjë apo pse është prezantuar kështu? Po ashtu, ka shumë faqe pa të dhëna, a nuk ka pasur planifikim në ato vija buxhetore?

Sa i përket programit të shpenzimeve për periudhën tetor-dhjetor, është shuma 3.675.000 euro. Kjo shumë më duket më e lartë krahasuar me periudhat paraprake, duke marrë parasysh buxhetin total të ndarë për këtë vit?

Enver Hoti - U thanë nga parafolësit shumë çështje dhe tani kemi një bord me punëtorë të rinj, por në bord vazhdojnë problemet e vjetra. Edhe në këtë raport financiar shihet se kemi tejkalime të shpenzimeve në mallra dhe shërbime mbi 125%. Ndërsa, në shpenzimet kapitale kemi “nënshpenzim” dhe kjo po ndodh vazhdimisht dhe nuk po kemi sqarime dhe nuk po e dimë arsyen?

Sa i përket të punësuarve, ju keni paraqitur numrin e aprovuar prej 766. Ndërsa, në një vizitë që kemi bërë në RTK, një grup punues i këtij komisioni në legjislaturën e kaluar, kemi marrë informata se janë 900 punëtorë të kategorive të ndryshme. Këtij raporti financiar është dashur ti bashkëngjitet një raport i auditimit të brendshëm. Unë do ta mbështes kërkesën për ndarjen e mjeteve, duke pasur parasysh që

punëtorët presin për pagat e tyre, por gjatë këtij mandati të vendosen forma dhe rregulla për menaxhimin e mjeteve financiare dhe financimin e këtij mediumi publik.

Safete Hadërgjonaj – Ajo që mendoj se është e mira e së mirës, që RTK-ja mos të financohet nga buxheti i republikës së Kosovës, dhe ne me iu qasë me seriozitet hartimit të ligjit dhe problematikës për financimin e RTK-së. Nëse ne nuk mund ta gjejmë një zgjidhje të tillë, unë konsideroj se prapë kemi me u përball me të njëjtat probleme. Ne si Kuvend duhet zgjidhur problemin e financimit me ligj dhe duhet nxituar me këtë çështje sepse kemi me u përball edhe me rastin e miratimit të Ligjit të Buxhetit 2018.

Pajtohem se duhet shikuar dhe analizuar më mirë kjo formë e raportimit dhe me qëllim që RTK-në ta fusim në sistem. Të gjitha institucionet tjera të pavarura që financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës i raportojnë Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe ne si komision e kemi bërë një formë të tillë të raportimit sepse nuk kemi parë asgjë më herët sepse nuk kanë sjell asgjë. Në bashkëpunim me projektin e GIZ-it, ne kemi hartuar këtë formë të raportimit e ndoshta është mirë si komision ta analizojmë këtë formë të raportimit financiar dhe t'i bëjmë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme.

Me qëllim që ta fusim këtë institucion në sistem kemi kërkuar që çdo tremujor të na sjellin planin e shpenzimeve dhe raportin financiar për tremujorin e kaluar dhe kjo është pak ngarkesë si për Komisionin, po ashtu edhe për RTK-në, që çdo tremujor buxheti që është ndarë të trajtohet në komision dhe të nxirret rekomandimi për Ministrinë e Financave për transferin e mjeteve në llogarinë e këtij mediumi. Unë mendoj që krahas formës së raportimit, duhet analizuar edhe mënyrën e raportimit, a është e nevojshme ndonjë qasje pak më ndryshe apo të vazhdojmë në këtë mënyrë për çdo tremujor në këtë mënyrë formale. Unë mendoj se do të ishte mirë me përcaktua për çdo gjashtë muaj.

Kryetari - Nuk është çështja e raportimit sa për sy e faqe e bërë si shabllon, sa me kalua çështjen, por duhet të binden deputetët e pozitës dhe opozitës për paratë që po shpenzohen për RTK-në. Pasqyrat që po jepen nga RTK-ja të paktën deri me tash, nuk mund të nxjerrim ndonjë konkluzion të një raporti që ka standarde minimale të raportimit dhe këta e dinë se si duket një raport i mirë. Megjithatë, RTK-ja e sheh buxhetin e qytetarëve si një thes që mundet me marrë para sa herë që donë dhe me i shpenzua si të dojë dhe pastaj të vinë në komision e të marrin përkrahjen, këtë nuk dëshirojmë ta shohim. Edhe në qoftë se na mund pozita me vota, prapë ne do të bëjmë kauzë edhe në Parlament dhe në institucione tjera. Kur të analizohet raporti, ashtu siç u theksua, investimet kapitale nuk janë realizuar, ndërsa mëditjet dhe udhëtimet jashtë vendit janë harxhura qind për qind. Kjo saktësi po të ishte tek investimet kapitale kritika jonë kishte me qenë më e butë. Ne do të rregullojmë çështjen e raportimit edhe për institucionet tjera, por për RTK-në do ta bëjmë një format standard të raportimit deri në hartimin e ligjit të ri për këtë medium.

Safete Hadërgjonaj – Do të doja që RTK-ja të mos shikohet e pozitës apo e opozitës. Është një medium publik dhe duhet shikuar nga të gjithë në këtë formë. Ne duhet ti qasemi me seriozisht institucionit e mos ta hedhim çështjen tek pozita apo opozita sepse forcat politike ndryshojnë e RTK-ja do të mbetet aty. Ne duhet të gjejmë zgjidhje dhe ti qasemi më seriozitet çështjes së buxhetit sepse të gjithë i kemi shqetësimet tona në lidhje me buxhetin e RTK-së.

Dardan Molliqaj –RTK-ja veç e publikut nuk është, por është e grupeve kriminale që vjedhin shumë para. Pra ky medium nuk është i qytetarëve dhe as i opozitës, por është e grupeve të individëve brenda pozitës. Mos na tregoni se çfarë duhet bërë sepse deri më tani keni menaxhuar dhe i keni dërguar drejtorët dhe këtë histori tashmë e dimë. Por, përkundër kësaj, ne u përmbajtem dhe thamë po flasim për aspektin financiar, sa para kemi, sa staf dhe si të menaxhohen këto para. Nëse bordi nuk e kryen punën e tij, ashtu siç tha edhe kryetari i Komisionit, duhet me i përdor të gjitha forcat që ky medium me iu kthye qytetarëve.

Safete Hadërgjonaj - Për mua është shqetësuese që në institucionin më të lartë në vend, që është Kuvendi, çdo fjalë që flitet, flitet për grupe kriminale dhe vjedhje. Unë jam ithtarë i asaj që çdo grup kriminal i kujt do qoftë, ta ketë vendin në burg. Nëse dikush i dinë grupet kriminale dhe hesht, duhet të merr përgjegjësinë e vetë, qoftë deputetë apo edhe qytetarë. Prandaj, të kursehem nga fjalët vjedhje e grupe kriminale e t'i analizojmë çështjet me seriozitet e ti kryejmë obligimet tona me përgjegjësi që kemi.

Ismet Bexhehti - Sa i përket standardit të raportimit, ky standard është dërguar nga Kuvendi dhe ka dy vite që punojmë me këtë standard. Ne jemi të gatshëm dhe mirëpresim përcaktimin e një standardi të ri sepse specifikat e mediumit janë të tjera. Sa i përket nivelit të shpenzimeve, ne kemi kërkuar raporte të detajuara për shpenzimet në baza tremujore, gjashtëmujore dhe nëntëmujore brenda vitit.

Sa i përket produkteve të reja në bazë të ligjit kemi të drejtë deri në 15-20% të produkteve të jashtme. Për të vlerësuar se a janë financat e mjaftueshme apo jo, kemi një krahasim me mediat publike rajonale dhe në Evropë dhe transmetuesi publik i Kosovës është 80 herë më i vogël se mediumet tjera publike. Ajo që është shqetësuese për ne si bord, janë borxhet që i kemi trashëguar që nga viti 2011, dhe çdo vit po përsëriten borxhet e njëjta.

Kryetari, pyeti, sa është shuma e borxheve që keni trashëguar?

Ismet Bexheti – Sa i përket borxheve, është e njëjta shifër siç ka qenë në vitin 2011, e që është 3 milion e diçka euro. Ne për shkak të mungesës financiare jemi të detyruar të blejmë edhe produkte të jashtme. Ne si bord në kuadër të kompetencave tona gjatë kësaj kohe jemi munduar ti gjejmë format, i kemi krijuar mekanizmat e brendshëm me qëllim që sistemi të jetë sa më funksional i kontrollit dhe e kemi arritur përmes akteve nënligjore. Po ashtu, kemi ngritur nivelin e auditimit të brendshëm. Në legjislaturën e kaluar sa kam qenë edhe unë kryetar, ne kemi bashkëpunuar me grupin punues të këtij komisioni, duke iu ofruar informata dhe të dhëna, sidomos për numrin e të punësuarve dhe ndër ta kemi pasur punëtor me kontrata mbi vepër dhe sot i kemi kthyer në punëtor të rregullt. Punëtorët me shërbime e kontrata mbi vepër janë me produksione të jashtme dhe një emision kërkon 20 apo 30 punëtorë me shërbime dhe nuk mund ta dimë numrin saktë pasi ndryshojnë shifrat në varësi të emisionit.

Enver Hoti – Mendoj që është mirë me vazhdua punën me grupin punues dhe kemi krijuar edhe një Komision Hetimor parlamentar, e nuk ka raportuar asnjëherë. Është e vërtetë se kemi pranuar listën e pagave, por tani në bazë të udhëzimit të inspektoratit, paska kaluar në një shkallë tjetër, prandaj është e nevojshme të vazhdojmë me grupin punues. Raportit i auditorit të brendshëm na ndihmon shumë po ta kishim, por nuk është bashkangjitur me materialin e dërguar.

Safet Zejnullahu - Tek formati i raportimi jam absolutisht dakord që edhe menaxhmenti edhe bordi të ulen bashkë dhe të bëjmë një format të raportimit profesional. Ne po raportojmë për pjesën e katërt të vitit dhe në të njëjtën kohë jemi para përgatitjes së raportit për vitin 2018 dhe sigurisht që do të kemi nevojë për ndihmën dhe profesionalizmin e secilit deputetë, në mënyrë që ta bëjmë një projeksion të mirë për vitin e ardhshëm, e mos të vijmë në situatë që të akuzohemi. Duke pasur parasysh mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme, ne si transmetues publik jemi ballafaquar me situatën që të mbulojmë fushatën zgjedhore dhe këto nuk kushtojnë pak dhe situata tjera të paparashikuara. Po ashtu, sa i përket objektit, pres ndihmën e këtij komisioni dhe Kuvendi, por edhe Qeverisë, të mendojmë për lokacionin sepse nuk lejohet të punojmë aty pasi që është pjesa e vjetër e qytetit. RTK-ja ka nevojë për ndihmë për digjitalizimin e arkivave të vjetra.

Një çështje tjetër që ka ndikuar në shpenzime të paparashikuara janë transmetimi i ndeshjeve të përfaqësueses së Kosovës në garat e FIFA-së dhe UEFA-së.

Mytaher Haskuka – Unë nuk jam i kënaqur me këto shpjegime që keni dhënë sepse ju po flisni për kablllo e për objekte, ndërsa në raport keni prezantuar shpenzimet kapitale të realizuara 50% dhe 25.000 euro i keni pasur fondet në dispozicion për të investuar në objekt.

Sa i përket transmetimit të Kampionatit Botëror, ju duhet të realizoni të ardhura nga reklamat dhe jeni në avantazh në këtë drejtim sepse nëse shpenzoni 300.000 euro për me marrë të drejtat e transmetimit të kampionatit, ju duhet me i fitua 1 milion euro. Po ashtu, nuk është e njëjtë si të ardhurat gjatë procesit normal si ato gjatë procesit zgjedhor, sepse çdo ditë e kam parë nga dy orë programi i sponsorizuar nga partitë politike. RTK-ja gjatë fushatës zgjedhore gjeneron të ardhura, prandaj është dashur të kemi një raport të veçantë për të hyrat nga marketingu dhe nga të tjera.

Safet Zejnullahu- Kemi pasur një periudhë të verës që është e mangët nga reklamat, e tani edhe fushatat zgjedhore dhe në raportin vjetor do ti keni të gjitha.

Kryetari – Ju lutem si bord komentet dhe vërejtjet t'i përcillni tek menaxhmenti dhe të na i ktheni arsyetimet, pse menaxhmenti nuk po i implementon këto vërejtjet tuaja, që janë njëjtë me tonat dhe duhet ditur përgjigjet e tyre sepse kjo është forma e komunikimit. Krejt çështja është tek efektiviteti i punës së RTK-së, sepse me rritjen e vazhdueshme të punëtorëve, ulen investimet kapitale. Ne nuk mund të krahasohemi me vendet evropiane, por 11 milionë euro nuk janë pak për standardin e Kosovës.

Unë propozoj që t'i rekomandojmë Ministrisë së Financave për transferin e mjeteve buxhetore në llogarinë e RTK-së, prej 1 milion e 700 mijë euro, për periudhën 1 tetor- 30 nëntor 2017, ndërsa shuma e mbetur prej 1.4 milion euro do të ndahet në muajin dhjetor, pas aprovimit të rishikimit të buxhetit.

Pas diskutimeve dhe në bazë të rekomandimit, kryetari konstatoi se Komisioni me pesë vota Për, katër Kundër dhe asnjë Abstenim, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Ministrisë së Financave, respektivisht drejtorit të përgjithshëm të Thesarit, të bëjë transferin e mjeteve buxhetore nga Llogaria e Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës, në buxhetin e Radiotelevizionit të Kosovës - kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, në llogarinë e RTK-së nr. 1110101219060187, për periudhën 1 tetor – 30 nëntor 2017, në shumën prej 1,700,000 (një milion e shtatëqind mijë) euro.

5. Të ndryshme.

Lumir Abdixhiku, kryetar- Me datën 14-16 nëntor, do të organizohet Konferenca Rajonale në Shkup, nga Westminster Foundation for Democracy, Rrjeti i Komisioneve Parlamentare për Ekonomi, Buxhet dhe Integritet Evropiane dhe Banka Botërore. Në këtë takim, jam ftuar unë dhe dy anëtarë tjerë. Unë nuk mund të shkoj, dhe propozoj që në këtë Konferencë të marrin pjesë Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani dhe Ali Lajçi.

Po ashtu, ju njoftoj se në bazë të kërkesës tonë, me rastin e shqyrtimit të rishikimit të buxhetit, Ministria e Financave ka dërguar materialin për projektet kapitale dhe i njëjti iu është përcjellë në formë elektronike.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

E përgatiti stafi mbështetës i Komisionit

**Kryetari Komisionit,
Lumir Abdixhiku**
